



**NGRITJA
E ZËRIT**

Tel: 044 195-113
044 633-325
Adresa: Rruga e UÇK-së,
Skenderaj
Email: info@ngritjaezerit.org
Web: www.ngritjaezerit.org

GJYKATES KOMUNALE NE SKENDERAJ

PADITES: Bekim Thaqi nga fshati Burojë, 41000 Skenderaj, Republika e Kosovës

E PADITUR: E PADITUR: REPUBLIKA E SERBISË –Qeveria e R.S. rr. e Nemanjës nr.11 11000 Beograd

PADI PER KOMPENZIM DEMI

Propozim për lirimin nga pagimi i shpenzimeve procedurale (sipas nenit 7 te Udhëzimit Administrativ nga K.GJ. 2008/02 dhe neni 468.1 te Ligji Nr. 03/L-006)

Objekt kontesti : Kompensimi dëmit

Vlera e kontestit : 857850€

1.) Paditësi është vëllai i te ndjerë Bislim Thaqit i cili nga ana e njësiteve paramilitare serbe me datën 30 mars te vitit 1999 është zënë, paraprakisht është torturuar dhe masakruar ne mënyrë çnjerëzore, është vrarë nga afërsia e pastaj është hedhur ne pusin (bunarin e bshkëfshatrait Rexh Halitit nga fshati Burojë.Pas lufte është gjetur në trupi i pa jetë i Bislim Thaqit, ndaj me ndihmën e KFOR-it është nxjerr nga pusi-bunari dhe është varrosur.

Tani familja e Bekim Thaqit numëron 7 anëtar te cilën e përbejnë: djemtë; Bekim dhe Shpetim Thaqi,pastaj nga reja Elfetja, nipat;Donarti dhe Bislimi si dhe mbesa Agnesa.

Provë : - Kërkesa për kompensimin e demave te luftës nr.580-106 e datës 16.01.2009
- Vërtetimi nga D.SH.M.S. 09 Nr. 580 te datës 16.01.2009 për vrasjen e vëllait Bislim Thaqit
- Deklarata për bashkësinë familjare nenë numrin rendor 03/1-196/035 e datës 16 janar 2009

Paditësi se bashku me anëtarët e familjes së ngushtë : djemtë; Bekim dhe Shpetim Thaqi, pastaj nga reja Elfetja, nipat;Donarti dhe Bislimi si dhe mbesa Agnesa, është pronar i sendeve te luajtshme dhe te pa luajtshme te cilat janë krijuar nga puna e përbashkët dhe trashëgimia , kjo patundshmëri përbehet prej shtëpisë me sipërfaqe prej 90 m² , dëmtim te kategorisë se V , me interier shtëpiak duke e përfshire tekniken e bardhe me pajisjet përkatëse në sallon dhe mobilierin e dhomave te gjumit , toka bujqësore , hamarin e drithit dhe koshit te misrit me plot misër, artikujve ushqimor pastaj mjeteve buqësore për punimin e tokës si në kërkesë.

Provë : - Vërtetimi i Drejtorisë së Urbanizmit nr.325- 53 te datës 15.01.2009

- Dëshmia mbi patundshmërinë UL-72015007-00032 ,dt. 15.01/09

2). Viktima nga forcat ushtarake policore serbe të udhëhequra direkt prej qeverisë së Serbisë e cila ka kryer veprime gjenocidiale , krime kundër njerëzimit ka humbur dhe vëllain si në kërkesë , i është shkatërruar pasuria , është detyruar ta braktis vendbanimin se bashku me anëtarët e familjes në kohë zgjatje prej 13 muaj e 10 ditë duke banuar nëpër shtëpi te shumta nëpër fshatra te ndryshme si në kërkesë .

Provë : - Dëgjimi i paditësit anëtarëve tjerë të familjes dhe provave te tjera te cilat paditësi do ti prezantoj ne seancat e shqyrtimit kryesor dhe ne rast nevojë te caktohet edhe eksperti përkatës.

4.) Të drejtën për kompensim paditësi e bazon në nenin 185 te LMD (G. Z. e RSFJ , Nr. 29 /78) në lidhje me nenin 180.1 te te njëjtit Ligj , me te cilin është paraparë që për demin e shkaktuar ndaj pasurisë te personave fizik si rezultat i dhunës dhe terrorit , përgjegjëse është „ Bashkia shoqërore politike ” e në këtë rast e paditura ka qenë e obliguar te pengoj aktet e vrasjes , dhunës , terrorit , dëmtimit , asgjësimit dhe vjedhjes se pasurisë se paditëses .

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e te Drejtave dhe Lirive te Njeriut (neni 1 Protokollin nr. 1 , neni 2 dhe protokollin nr. 6 , neni 3 , neni 5 (5) , neni 10 dhe neni 14) .

Paditësi propozon qe kjo Gjykatë të caktoj shqyrtimin kryesor te çështjes , t'i shfrytëzoj informatat e duhura nga mjetet provuese të propozuara dhe

1.) pastaj të bien këtë :

AKTGJYKIM

I. Aprovohet kërkesë padija e paditësit Bekim Thaqit nga fshati Burojë, 41000 Skenderajt Republika e Kosovës në tersi si e bazuar .

II. Obligohet e paditura Republika e Serbisë - Qeveria e R.S. si pasardhëse juridike e Qeverisë se me parshme qe ne emër te te njëjtës te kompensoj demin material dhe jo material paditësit Bekim Thaqit,nga f.sh.Burojë, 41000 Skenderajt Republika e Kosovës, duke ja paguar :

- shumen prej 600.000 €për vëllain e vvarë
- shumen prej 55650 €për dhembjen shpirtërore dhe te munduarit , ndjekjes nga shtëpia , banimi ne qiell te hapur dhe shtëpi te huaja ne kohëzgjatje prej 4 muaj
- shumen prej 50 000 për shkak te pamundësuarit e kremtimit te festave fetare ne shtëpi, vizitën dhe nderimin e varrezave , humbjes se kontaktit me farefis dhe te afërmit
- shumen prej 135 000 €për shtëpinë e djegur dhe te shkatërruar
- shumën prej 10 000 €për; hamarin me drith, koshin me miser, fllanikun(objekt i bylmetit) miellin, kruneve dhe artikujve tjerë ushqimore te gjitha te djegura tersisht
- Shumën prej 7 200 €për traktorin e plaqkitur se bashku me ramin,pllugjit dhe vllaqat
- shumen prej ----- €për pamundësimin e shfrytëzimit te tokës bujqesore për tri vite

te gjitha këto shuma me kamat ligjore qe nga dita e ngritjes se padisë e deri ne ditën e pagesës definitive të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit , nen kërcënim te përmbarimit te dhunshëm .

Pala e paditur te paguaj shpenzimet procedurale te kësaj çështje juridike në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se aktgjykimit, nen kërcënim te përmbarrimit te dhunshëm .

1.) të bihet :

AKTVENDIM

Mbi miratimin e propozimit te paditëses në ter çështjen juridike mbi lirimin nga pagimi i taksave dhe shpenzimeve tjera procedurale duke marr parasysht gjendjen e vështir ekonomike te paditëses ne kuptim me nenin te Udhëzimit Administrativ nga K.GJ. 2008/02 dhe neni 468.1 te Ligji Nr. 03/L-006 .

Skenderaj , me dt. 03.05.2010

Paditësi

Bekim Thaqi



Shtojcë ;

1. Kërkesa për kompensimin e dëmeve te luftës nr.580-106 e datës 16.01.2009
2. Vërtetimet e D.SH.M.S. 09 Nr. 580 te te datës 16.01.2009 për vrasjen e vëllaut Bislim Thaqit
3. Deklarata për bashkësinë familjare nenë numrin rendor 03/1-196/035 e datës 16 janar 2009
4. Certifikata mbi te drejtat e pronës së paluajtshme, UL- 72015007-00032 ,dt.15.01/09
5. Vërtetimi I Drejtorisë së Urbanizmit, nr. 325- 53 te datës 15.01.2009
6. 4 kopje te padisë